



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____. 2015

U D H Ë Z I M

Nr.11, Datë 22/05/2015

“Për procesin e pezullimit, modifikimit të dokumentave standarde të tenderit dhe shtyrjen e afatit të procedurave të prokurimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik”

Agjencia e Prokurimit Publik, në mbështetje të nenit 13 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 83, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 918, datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”,

UDHËZON:

Në procesin e prokurimit publik me mjete elektronike, përgjigjet për kërkesat për sqarim mbi dokumentet e tenderit, modifikimi i dokumentave të tenderit dhe shtyrja e afatit të pritjes dhe hapjes së ofertave, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, bëhen nga vetë Autoriteti Kontraktor.

Me anë të përdorimit të sistemit të prokurimit elektronik, ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, dhe ky i fundit duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, sipas Nenit 42 të LPP.


Autoriteti kontraktor duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, duke bashkëlidhur përmbajtjen e kërkesës për sqarim dhe përgjigjen e dhënë nga autoriteti kontraktor, në fazën “Dokumentet e tenderit” në sistemin e prokurimit elektronik (skedar .doc ose .pdf).

Për të hedhur në sistemin e prokurimit elektronik, sqarimet si më sipër, autoriteti kontraktor duhet më parë të pezullojë teknikisht në sistem procedurën e prokurimit në


fjalë, të bashkëlidhë dokumentat përkatës dhe më pas të nxjerrë menjëherë procedurën nga pezullimi.

Në mënyrë që të bëni teknikisht një pezullim të një procedure prokurimi në sistem, duhet që më parë të logohet “Administratori” i autoritetit tuaj kontraktor.


Tek skedari “Shpalljet e pa pezulluara” – (Not suspended calls) administratori kërkon dhe përzgjedh procedurën e prokurimit që duhet të pezullohet dhe klikon mbi butonin “Suspend”. Në dritaren që shfaqet do të jepni arsyet e këtij pezullimi dhe do të klikoni butonin “Tjetër”.



Pasi të keni kryer këtë veprim, do të shikoni që procedura e prokurimit ka kaluar tek skedari “Shpalljet e pezulluara”.




Pas këtij veprimi që bën “Administratori” i autoritetit kontraktor, nëpunësi i autorizuar i njësisë së prokurimit duhet të logohet në sistem, dhe tek skedari “Shpalljet e pezulluara” gjen procedurën e prokurimit të pezulluar.




Kujdes: Procesi i pezullimit teknikisht në sistem, bëhet vetëm për procedurat e prokurimit që janë në pritje të ofertave, deri në datën dhe orën e përcaktuar si “Afati i fundit për pranimin e ofertave” dhe “Data e zhvillimit të tenderit”.

Për të bashkëlidhur sqarimet/dokumentin e modifikuar, nëpunësi i autorizuar i njësisë së prokurimit duhet të klikojë në fazën “Dokumentet e Tenderit” dhe me anë të opsionit “Shto një dokument” do të shfaqet dritarja ku mund të bashkëlidhni dokumentin përkatës.



Pas veprimeve të mësipërme, do të shikoni që në sistem është shtuar sqarimi/dokumenti i modifikuar.



Në rastin e modifikimeve, (jo në rastin e sqarimeve) duhet të bëhet edhe shtyrja e datave të përcaktuara më parë si “Afati i fundit për pranimin e ofertave” dhe “Data e zhvillimit të tenderit”. Për të realizuar ndryshimin e datës në sistem duhet të klikoni dy herë mbi fazën “Informacioni Administrativ” dhe në dritaren që iu shfaqet duhet të bëni ndryshimet përkatëse. Pasi të keni bërë ndryshimin e datës tek fusha e “Afati i fundit për pranimin e ofertave” dhe “Data e zhvillimit të tenderit” klikoni butonin përditësim dhe “Hapi tjetër” në mënyrë që të ruhet informacioni.

Kujdes: Vetëm gjatë kohës që procedura e prokurimit është e pezulluar teknikisht në sistem, nëpunësi i autorizuar i njësisë së prokurimit mund të shtojë dokument të ri tek faza “Dokumentet e tenderit”, dhe tek faza “Informacioni Administrativ” mund të bëjë shtyrjen e datave të përcaktuara më parë si “Afati i fundit për pranimin e ofertave” dhe “Data e zhvillimit të tenderit”.

Pasi janë bërë të gjitha modifikimet në sistem, nga nëpunësi i autorizuar i njësisë së prokurimit, “Administratori” i autoritetit kontraktor duhet të nxjerrë procedurën e prokurimit nga pezullimi.

Kujdes: Veprimi i nxjerrjes së procedurës së prokurimit nga pezullimi duhet të bëhet vetëm pasi të jetë verifikuar dhe konfirmuar tek faza “Informacioni Administrativ” shtyrja e datave të përcaktuara më parë si “Afati i fundit për pranimin e ofertave” dhe “Data e zhvillimit të tenderit”. Në rast se procedura e prokurimit nxirret nga pezullimi dhe data e zhvillimit të saj ka kaluar (pra nuk janë bërë ndryshimet tek faza “Informacioni Administrativ”), teknikisht nuk mund të bëhet më procesi i pezullimi nga “Administratori” i autoritetit kontraktor.

Për të nxjerrë nga pezullimi procedurën e prokurimit, administratori duhet të logohet në sistem dhe tek skedari “Shpalljet e pezulluara”, përzgjedh procedurën përkatëse. Më pas, klikon butonin “Un-Suspend” dhe në dritaren që shfaqet do të vendosen arsyet e heqjes së pezullimit për këtë procedurë.

Në rast se AK duhet të pezullojë një procedurë prokurimi, pasi është bërë hapja e ofertave, teknikisht në sistem nuk kryhet asnjë veprim. Në këtë rast, me daljen e urdhrin të Titullarit të AK-së për pezullimin e procedurës, nuk duhet të vijohet me zhvillimin e procedurës (nga anëtarët e KVO-së dhe anëtarët e njësisë së prokurimit nuk duhet të bëhet asnjë veprim në sistem), deri në momentin e heqjes së urdhrin të pezullimit nga Titullari i AK-së.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Eduard Ahmeti